

**VENDIM**  
**Nr.440, datë 13.7.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE**  
**MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave, të parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

**STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË**

| EMËRTIMI |                                                                                                                                                                                                                                                              | PAGA MUJORE        |                           |                                     |                           |               |
|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|---------------------------|-------------------------------------|---------------------------|---------------|
|          |                                                                                                                                                                                                                                                              | PAGA INDIVIDUALE   |                           |                                     | SHITESA E PROFESIONIT     |               |
|          |                                                                                                                                                                                                                                                              | Paga e Grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK)         | Shtesa për pozicion (SHP) | Totali        |
|          |                                                                                                                                                                                                                                                              | 1                  | 2                         | 3                                   | 4                         | 5 = (1+2+3+4) |
| 1        | Drejtor i shkollës së mesme.<br>Përgjegjës poligoni.<br>Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë.<br>Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë.<br>Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore.<br>Drejtor i konvikteve.                 | 1                  | 2% e P.G .                | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 35560                     |               |
| 2        | Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme.<br>Përgjegjës i bazës prodhuese.<br>Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë.<br>Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë.<br>Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore. | 1                  | 2% e P.G .                | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 28500                     |               |
| 3        | Drejtor i shkollës 8-vjeçare.                                                                                                                                                                                                                                | 1                  | 2% e P.G .                | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 27950                     |               |
| 4        | Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV-ërt. Përgjegjës (kryemesues) i shkollës me klasë kolektive.<br>Zëvendësdrejtor i shkollës 8-vjeçare.                                                                                                                   | 1                  | 2% e P.G .                | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 25800                     |               |
| 5        | Drejtor i kopshtit me ushqim.                                                                                                                                                                                                                                | 1                  | 2% e P.G .                | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 24200                     |               |

|    |                                                                                                                                                                                         |   |            |                                     |       |  |
|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|------------|-------------------------------------|-------|--|
| 6  | Drejtor i kopshtit pa ushqim.                                                                                                                                                           | 1 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 22070 |  |
| 7  | Mësues në shkollat e mesme.<br>Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë.<br>Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë.<br>Mësues në shkollat me probleme të larta mendore. | 1 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 25750 |  |
| 8  | Mësues në shkollat 8-vjeçare, klasa I-VIII.<br>Edukator konvikti.<br>Kujdestar konvikti.                                                                                                | 1 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 21560 |  |
| 9  | Edukator në kopësht fëmijësh.                                                                                                                                                           | 1 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 15900 |  |
| 10 | Mësues                                                                                                                                                                                  | 2 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 17600 |  |
| 11 | Mësues                                                                                                                                                                                  | 3 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 17600 |  |
| 12 | Edukator në kopësht fëmijësh.                                                                                                                                                           | 3 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 15750 |  |
| 13 | Edukator në kopësht fëmijësh.                                                                                                                                                           | 2 | 2% e P.G . | 5 % e P.G<br>10% e P.G<br>20% e P.G | 15750 |  |